



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren- Prizren Belediyesi

DATË:	15.01.2026
PËR:	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës
CC:	Muharrem Fazliu, Kryesues i KA
PËRMES:	/
NGA/OD/FROM:	Agron Hoxha, Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm
TEMA:	RAPORT VJETOR I PUNËS I NJËSISË PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM për vitin 2025



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Njësia e Auditimit të Brendshëm

RAPORT VJETOR I NJAB

AUDITIMET E PËRFUNDUARA DHE
AKTIVITETET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

JANAR
DHJETOR
2025

PRIZREN, JANAR 2026

Përmbajtja

1. Adresimi i udhëheqësit të njësisë së Auditimit të Brendshëm	5
2. Hyrje	5
2.1. Pozicionimi dhe funksioni i NjAB-së	5
2.2. Funksionet kryesore të NJAB	5
3. Objektivat e auditimit të brendshëm për vitin 2025.....	6
3.1. Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve	6
3.2. Realizimi i detyrave audituese.....	6
3.3. Raportimi periodik	6
3.4. Bashkërendimi institucional dhe shërbimet këshilluese	6
4. Rezultatet kryesore për periudhën janar-dhjetor 2025	6
4.1. Auditimet e realizuara për periudhën janar-dhjetor 2025	6
4.2. Rekomandimet dhe niveli i zbatimit.....	6
5. Detyrat dhe aktivitetet tjera audituese.....	7
6. Sfidat e Auditimit të Brendshëm	7
7. Përfundim	7

Shkurtesat

NjAB – Njësia e Auditimit të Brendshëm

AB – Auditimi i Brendshëm

USSP – Udhëheqësi i Subjektit të Sektorit Publik

DKA – Drejtoria Komunale Arsimit

DBF – Drejtoria për Buxhet dhe Financa

ZKA – Zyra Kombëtare e Auditimit

MFPT - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

NJQHAB – Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm

PVF – Pasqyrat Vjetore Financiare

SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës

ZKF – Zytari Kryesor Financiar

1. Adresimi i udhëheqësit të njësisë së Auditimit të Brendshëm

Kam kënaqësinë e veçantë të prezantoj Raportin Vjetor të Punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) në Komunën e Prizrenit për periudhën janar–dhjetor 2025. Ky raport është përgatitur në përputhje me nenin 25, paragrafi 3.5 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, si dhe në pajtim me metodologjinë e auditimit të brendshëm të miratuar nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm (NjQHAB) në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Raporti paraqet një përmbledhje të detyrave dhe aktiviteteve audituese të realizuara gjatë vitit 2025 dhe pasqyron funksionimin e sistemit të kontroleve të brendshme në Komunën e Prizrenit. Ai shërben për informimin dhe nevojat e Kryetarit të Komunës, Komitetit të Auditimit dhe NjQHAB/MFPT.

Raporti është përgatitur në bazë të Planit Vjetor të Punës së NJAB për vitin 2025 dhe reflekton aktivitetet e realizuara në përputhje me mandatin ligjor të kësaj njësie.

2. Hyrje

Në bazë të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Kapitulli III, Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Prizrenit ka obligim të hartojë raport vjetor për aktivitetet e realizuara dhe ta paraqesë atë tek Kryetari i Komunës, Komiteti i Auditimit dhe Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm në kuadër të MFPT-së.

Ky raport është përgatitur sipas formatit standard të përcaktuar nga NjQHAB dhe përmban në mënyrë të strukturuar gjetjet kryesore, përfundimet që rrjedhin nga vlerësimi i rreziqeve, si dhe rekomandimet për përmirësim.

2.1. Pozicionimi dhe funksioni i NJAB-së

Njësia e Auditimit të Brendshëm është e sistemuar në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Prizrenit dhe funksionon në bazë të nenit 21 të Ligjit nr. 06/L-021. NJAB ushtron funksionin e saj në mënyrë të pavarur dhe i raporton drejtpërdrejt Kryetarit të Komunës, duke e njoftuar njëkohësisht Komitetin e Auditimit. Njësia gëzon pavarësi funksionale në planifikimin, realizimin e auditimeve dhe raportimin e rezultateve.

2.2. Funksionet kryesore të NJAB:

- Ofrimi i sigurisë së pavarur dhe objektivë për efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- Vlerësimi i qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit;
- Ofrimi i shërbimeve këshilluese, konsultative dhe trajnuese, në pajtim me udhëheqësin e subjektit.

3. Objektivat e auditimit të brendshëm për vitin 2025

3.1 Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NJAB dhe Zyra Kombëtare e Auditimit.

3.2 Realizimi i detyrave audituese

Zbatimi i Planit Vjetor të Punës për vitin 2025, i cili ka përfshirë gjashtë (6) detyra audituese dhe dy (2) auditime për rishikimin të rekomandimeve.

3.3 Raportimi periodik

Raportimi i rregullt gjashtëmujor dhe vjetor tek Kryetari i Komunës, Komiteti i Auditimit dhe NjQHAB/MFPT.

3.4 Bashkërendimi institucional dhe shërbimet këshilluese

Bashkëpunimi me ZKA, NjQHAB, Komitetin e Auditimit dhe ofrimi i këshillave profesionale për drejtoritë komunale.

4. Rezultatet kryesore për periudhën janar-dhjetor 2025

4.1. Auditimet e realizuara për periudhën janar-dhjetor 2025:

1. Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve për vitin 2024, është dhënë 1 rekomandim;
2. Subvencionet dhe transferet, janë dhënë 4 rekomandime;
3. Planifikimi dhe inkasimi i të hyrave komunale, është dhënë 1 rekomandim;
4. Auditimi i performancës: menaxhimi i pasurisë jo financiare, janë dhënë 5 rekomandime;
5. Menaxhimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime, janë dhënë 3 rekomandime;
6. Pajtueshmëria në prokurim, janë dhënë 4 rekomandime;
7. Menaxhimi i investimeve kapitale, janë dhënë 4 rekomandime.

4.2. Rekomandimet dhe niveli i zbatimit

Gjatë vitit 2025 janë dhënë gjithsej 21 rekomandime:

- Rekomandime të zbatuara: 10 (48%);
- Rekomandime në proces zbatimi: 7 (33%);
- Rekomandime të pazbatuara: 4 (19%).

5. Detyrat dhe aktivitetet tjera audituese

- || Bashkërendimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- || Hartimi i raporteve periodike për zbatimin e rekomandimeve (për periudhat: **janar, mars, korrik** dhe **shtator 2025**);
- || Raportimi i gjashtëmujorit të parë (I) dhe të dytë (II) si dhe raporti vjetor (për periudhat: **janar, korrik**)
- || Organizimi/mbajtja e takimeve të rregullta të Komitetit të Auditimit, për vitin 2025 janë mbajtur katër (4);
- || Pjesëmarrje në projekte dhe punëtori profesionale (DEMOS, OSBE, NjQHAB);
- || Ofrimi i shërbimeve këshilluese për stafin dhe menaxhmentin komunale.

6. Sfidat e Auditimit të Brendshëm

Auditimi i brendshëm në Komunën e Prizrenit përballet me sfida të ngjashme me ato të organizatave tjera buxhetore. Sfida kryesore mbetet mungesa e stafit të mjaftueshëm dhe e kapaciteteve profesionale, e cila ndikon drejtpërdrejt në mbulimin e plotë të fushave me rrezik.

Një tjetër sfidë është niveli i zbatimit të rekomandimeve. Përkundër progresit të arritur, ende vërehet vonesë ose zbatim i pjesshëm i disa rekomandimeve, që kërkon angazhim më të madh të menaxhmentit dhe drejtorive komunale. Po ashtu, ndryshimet e shpeshta ligjore dhe rezistenca institucionale ndaj rekomandimeve përbëjnë pengesa shtesë në rritjen e efektivitetit të auditimit të brendshëm.

7. Përfundim

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka kontribuar në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar në Komunën e Prizrenit. Megjithatë, për rritjen e mëtejme të efektivitetit kërkohet përkrahje institucionale, plotësim i stafit dhe përkushtim më i madh në zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Agron Hoxha

Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm
